

MARRËVESHJE PËR BLERJE KUOTE

Ne Tirane, sot me date 22.04.2024 (dymije e njëzet e katër), lidhet kjo marrëveshje per shitblerje kuotash ndermjet paleve si ne vijim:

1. **Shoqëria "Green Coast" Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L41329038D, me seli në Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 3, Kati 1, Tirane, Shqiperi", përfaqësuar nga administratori Z. Armando Alicanaj, shtetas shqiptar, lindur më 05.10.1979, në Fier, mbajtës i pasaportës me nr. BC5216331, dhe me numër personal H91005012U, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar (më poshtë referuar si "Shites")
2. **Shoqëria "BREGU" SH.A**, një shoqëri ndërtimi dhe projektimi e organizuar në bazë të ligjeve të Shqipërisë, me numër NIPT-i, J64103021R, me seli në adresën Rr: "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, Kati 2, D 11, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar rregullisht nga administrator Znj. Tatiana Bregu (më poshtë referuar si "Bleres")

Palët kanë vendosur dhe rënë dakord si me poshtë:

vijon:

1. Shitësi gëzon të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë dhe zotërimit të **1 (një)** kuote me një vlerë nominale prej **857,500 LEK** (tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind lekë), të cilat përfaqësojnë **100%** (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë 'Seaside Hospitality sh.p.k.', shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën Rr "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti nr. 31, Tiranë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NUIS: M11401020A, përfaqësuar nga Administratori Znj. Dea Filipi" ("Kuota").
2. Shitësi shet, transferon dhe dorëzon pronësinë e plotë dhe zotërimin e Kuotës të cilësuar këtu më sipër, konkretisht të **1 (një)** kuote me një vlerë nominale prej **857,500 LEK** (tetëqind e shtatë mijë e pesëqind lekë), të cilat përfaqësojnë **100%** (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë Seaside Hospitality sh.p.k., dhe të gjitha të drejtat e detyrimet që ai gëzon si ortak, ja kalon blerësit, i cili pranon t'i blejë, për një çmim të barabarte me **929,500 LEK** (nëntëqind e njëzet e nënte mijë e pesëqind lekë), (këtu e tutje referuar si "Çmimi").
3. Blerësi do të paguajë brenda dites se neserme te firmosjes se kesaj kontrate çmimin e plote prej **929,500 LEK** (nëntëqind e njëzet e nënte mijë e pesëqind lekë, në llogarinë bankare të Shitësit me këto të dhëna:

Emri i Bankës: Tirana Bank SH.A.
Titullari i llogarisë: Green Coast Sh.p.k.
NR.Llogarie: 0110-319705-101
IBAN: AL49 2061 1011 0000 1103 1970 5101
Monedha: ALL

4. Shitësi në këtë mënyrë deklaron që Kuota e transferuar në bazë të kësaj marrëveshjeje është e lirë dhe e pastër nga çdo peng, barrë siguruuese, kufizim, garanci e një tjetër natyre, kufizim ose nga ndonjë pengesë ligjore në përgjithësi.
5. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje dhe ne cdo rast me shlyerjen e çmimit të shitjes, Shitësi nuk ka dhe nuk do të këtë ndonjë pretendim tjetër përkundrejt Blerësit në lidhje me blerjen e Kuotës së mësipërme.

Në çdo rast vetëm pagesa e plotë e Çmimit nga Blerësi është kusht thelbësor për përfitimin e pronësisë së Kuotës nga Blerësi sipas objektit të kësaj marrëveshje. Me pagesën e plotë të Çmimit nga Blerësit, shitja quhet e kryer dhe Blerësi përfiton pronësinë e Kuotës.

6. Pas transferimit të mësipërm të Kuotës, veprim i cili për të shmangur çdo dyshim do të jetë i vlefshëm dhe ekzekutohet në zyrën e qendrës së biznesit (QKB) vetëm pasi të jetë paguar çmimi i plotë në përputhje me pikat (2), (3) dhe (5) më lart, Shitësi nuk gëzon më asnjë të drejtë ose titull mbi Kuotën e mësipërme dhe Blerësi, të cilit kuota i është transferuar dhe dorëzuar, përsa i përket pronësisë dhe posedimit, do të gëzojë të drejtën t'a zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe disponojë ato me vullnetin e tij të lirë si pronar dhe posedues i saj. Blerësi gëzon të drejtën të ushtrojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.
7. Blerësi do të vijojë me regjistrimin e nevojshëm të transaksionit në fjalë në Regjistrin e Biznesit të mbajtur në Qendrën Kombëtare të Biznesit vetëm pasi të jetë paguar Çmimi i plotë në përputhje me pikat (2) dhe (3) më sipër.
8. Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj marrëveshje do të paraqitet për zgjidhje pranë Gjykatave kompetente të Tiranës.
9. Palët kontraktore sipas kësaj marrëveshje heqin dorë nga çdo e drejtë e ankimimi të kësaj marrëveshje.
10. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dy palët.

Kjo Marrëveshje hartohet ne 2 (dy) kopje me permbajtje dhe fuqi te njejte ligjore.

PALËT KONTRAKTORE

SHITËSI

Armando Alicana

Green Coast Sh.p.k.
përfaqësuar nga Z. Armando Alicana



GREEN COAST
L41329038D

BLERËSI

Albi Shyti

BREGU SH.A
përfaqësuar nga Z. Albi Shyti

